




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>2-D/DPK</u>	Br. Prot. <u>01-2900/15</u>
Dep. <u>02</u>	Prot No. <u>01-2900/15</u>
Nr. l faq.	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>25-09-2015</u>
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 23.09.2015, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-2500-15 për z. *Ali Sadriu* – *Deputet ne Kuvendin e Kosoves, për shkak se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z. Sadriu ka dhënë dorëheqje nga pozita e personit të autorizuar në biznesin privat.***

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

**I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-2500-15, për Zyrtarin e lartë, z. *Ali Sadriu* – *Deputet i Kuvendit të Kosovës, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).***

Zyrtari i lartë, z. *Sadriu* fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./03-02-2500/15), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. *Sadriu*, është deklaruar se do t'i bëjë ndryshimet e kërkuara në Agjencionin për regjistrimin e Bizneseve të Kosovës.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka dërguar shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-02-2833/15) në të cilën shihet se tashmë ka hequr dorë tërësisht nga funksioni i personit të

autorizuar të biznesit privat “Innovative Securities NBFI-IS” sh.p.k. duke shmangur kështu konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni

